



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ÇËRRIK

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Bashkia Cerrik
Adresa Lagja nr.2 rruga "Gjimnazistet 1962"
Tel/Faks _____
E-mail bashkiacerrik@yahoo.com
Ueb-faqe www.bashkiacerrik.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Irisa Çipi
E-mail cipi.irisa@yahoo.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur e thjeshtuar

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuader: Sherbime

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-81994-04-15-2026

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Organizim eventesh ne Bashkine Cerrik"

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 79952000-2 sherbime te organizimit te eventeve, 39298900-6 sende të ndryshme dekorativë

8. Fondi limit : 2.999.500 (dy million e nenteqind e nentedhete e nentew mije e peseqind) leke pa tvsh.

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit: AK do të ndryshojë/sqarojë dokumentat e tenderit pas vendimit nr. 1281/2023 date 12/12/20123 duke u mbështetur në LPP 162 Datë 23.12.2020, Neni 75 - Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit, pika 2. *Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce.*

Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave.

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet **afati i ri i përcaktuar:**

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA CËRRIK

Nr. _____ Prot

Cërrik më 21.04.2026

S H T O J C E

Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “**Organizim eventesh ne Bashkine Cerrrik**” për procedurën e prokurimit “**Organizim eventesh ne Bashkine Cerrrik**” me fond prej : 2.999.500 (*dy million e nentëqind e nentëdhjete e nentew mije e peseqind*) leke pa tvsh. dhe nr. Reference te procedures : **REF-81994-04-15-2026**. Në zbatim të nenit 75 pika 2 të Ligjit Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe pas koordinimit të APP bëhen ndryshimet si me poshte vijon:

ISHTE:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet 2023,2024,2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar., ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

BEHET:

Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit, 2023, 2024 dhe 2025, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës “c” të neni 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

ISHTE:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

BEHET:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

ISHTE:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 5 punonjës per muajin e fundit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe vertetimim per pagesen e kontributeve.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

BEHET:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 3 punonjës për muajin e fundit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimin për pagesën e kontributeve.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqese përpara njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar të parashikuar në shkronja "a" "b" "c" etj si dhe dokumentat shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike.

ISHTE:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të pakten mjetet dhe makinerite e mëposhtme:

Mjet me vinc	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
--------------	--------------	------------------------

a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

Kontratë qiraje.

Ne cdo rast të shoqeruara me:

1. Leje qarkullimi e mjetit;
2. Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;
4. Fotot perkatese;

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit ose faturat e shitjes të shoqeruara me dokumentacion pronesie të shitesit (zhdoganim apo kontrata blerjeje) si dhe fotot, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të jetë për të gjithë periudhën e realizimit deri në perfundimin e plote të punimeve

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

BEHET:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të pakten mjetet dhe makinerite e mëposhtme:

Mjet me vinc	cope 1 (nje)	Ne pronesi ose me qera
--------------	--------------	------------------------

c) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

Kontratë qiraje.

Ne cdo rast te shoqeruara me:

5. Leje qarkullimi e mjetit;
 6. Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;
 7. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;
 8. Fotot perkatese;
- d)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit ose faturat e shitjes te shoqeruara me dokumentacion pronesie te shitesit (zhdoganim apo kontrata blerjeje) si dhe fotot, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te jete per te gjithë periudhen e realizimit deri ne perfundimin e plote te punimeve.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Operatori ekonomik duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar te parashikuar ne shkronja "a" "b" "c" etj si dhe dokumentat shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike

Termet e references/Specifikimet ndodhen bashkengjitur dokumentave te tenderit ne folderin (preventiv).

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 27.04.2026 Ora:08:10

Vendi: www.app.gov.al

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Tomorr Zaimaj**